UDHËZIM
Nr. 10496, datë 31.7.2018

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 332, DATË 6.6.2018 "PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 547, DATË 9.8.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 6.6.2018, "Për disa shtesa në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në zbatim të pikës 1, germa "a", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 6.6.2018 "Për disa shtesa në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", të ndryshuar", "Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penaliteti vlerësimi do t'i referohet mesatares së prodhimit të energjisë elektrike, duke filluar nga viti i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralit", përllogaritja do të bëhet duke mbledhur sasinë e plotë vjetore të energjisë elektrike të prodhuar gjatë 5 viteve, vërtetuar me dokumentacionin përkatës të konfirmuar nga OSHEE sh.a. dhe duke e pjesëtuar me numrin 5 (pesë), që jep sasinë mesatare të energjisë elektrike të prodhuar në një vit.

Në qoftë se kjo shifër është më e vogël se vlera mesatare vjetore e energjisë elektrike e përcaktuar në Kontratën e Koncesionit, atëherë subjekti koncesionar penalizohet në masën e përcaktuar në Kontratën e Koncesionit.

Periudhë 5-vjeçare, për efekt të këtij vendimi, konsiderohet periudha e 5 viteve të plota kalendarike, që fillon në datën 1 janar të vitit pasardhës të vitit në të cilin hidrocentralit është vënë në punë me kapacitet të plotë të instaluar sipas kontratës së koncesionit dhe mbaron në datën 31 dhjetor të vitit të 5 kalendarik, duke filluar nga data 1 janar e përcaktuar si më sipër.

2. Në zbatim të pikës 1, germa "b", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 332 datë 6.6.2018 "Për disa shtesa në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", të ndryshuar", procesi i vlerësimit të investimeve të kryera për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, do të kryhet në bashkëpunim me ekspertë vlerësues të pavarur, të caktuar nga ministri përgjegjës për energjinë.

Vlerësimi i investimit do të kryhet në zbatim të standardeve dhe legjislacionit në fuqi për këtë qëllim, mbështetur në të gjitha dokumentet ligjore dhe teknike të nevojshme (projektzbatimin e miratuar, situacione punimesh, fletëprojekti, fatura tatimore dhe doganore etj.), të depozituara në AKBN, duke i ballafaquar këto me investimet e kryera në fakt sipas inspektimit në terren, dhe çdo dokumenti tjetër të vënë në dispozicion nga koncesionari.

Raporti i vlerësimit i përgatitur paraprakisht nga eksperti vlerësues i pavarur, do të shqyrtohet nga një komision prej tre anëtarësh (ekspertë të fushave përkatëse dhe jurist) i ngritur pranë AKBN-së, në përbërje të të cilit do të jenë: dy përfaqësues nga AKBN-ja, ku përfshihet dhe kryetarit, dhe një përfaqësues nga MIE.

Në përfundim të shqyrtimit të Raportit të Vlerësimit dhe të korrigjimeve të mundshme, Komisioni harton një dokument përmbledhës rreth Raportit dhe punës së Komisionit. Një kopje e plotë e vlerësimit të Ekspertit Vlerësues dhe e materialit të hartuar prej Komisionit duhet t'i përcillet ministrit përgjegjëse për energjinë për miratim dhe për njoftim të koncesionarit.

Anëtaret e komisionit, do të mbajnë përgjegjësi ligjore për hartimin e dokumentacionit të nënshkruar prej tyre.

Pagesa e Ekspertëve Vlerësues do të mbulohet nga subjekti që realizon projektin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, dhe do të kryhet pas përfundimit dhe miratimit të raportit të vlerësimit. Pagesa e ekspertëve vlerësues do të jetë 2% e vlerës së investimit të kryer, por në çdo rast kjo pagesë nuk do të jetë më pak se 200,000 lekë dhe jo më shumë se 600,000 lekë.

3. Në zbatim të këtij vendimi, të gjitha aktet nënligjore dhe administrative për vlerësimin e investimeve të kryera për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, të nxjerra përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të konsiderohen të vlefshme.

4. Ngarkohen strukturat përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri